

**UNITED
NATIONS**
United Nations
Interim
Administration
Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission
d'Administration
Intérimaire des
Nations Unies au
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

TRANSKRIPTI
SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS
TË MBAJTUR MË 14.9.2006

TRANSKRIPT
SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA
ODRŽANE 14.09.2006

SHTATOR-SEPTEMBAR 2006

RENDI I DITËS

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 31 gushtit 2006,
3. Shqyrtimi i raportit të Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit për punën njëvjeçare 2005,
4. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Gatishmëri dhe Emergjencë, pas përfundimit të Projektit të trajnimit për marrjen e kompetencave të kontrollit parlamentar në fushën e sigurisë,
5. Shqyrtimi i rekomandimit të Panelit të Veçantë lidhur me mocionin në Ligjin për përdorimin e gjuhëve,
6. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit Legjislativ për miratimin e listës së kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë.

DNEVNI RED

1. Usvajanje dnevnog reda,
 2. Usvajanje zapisnika sa plenarne sednice od 31. avgusta 2006.godine,
 3. Razmatranje Izveštaja Regulatornog autoriteta telekomunikacija o jedngodišnjem radu za 2005 godinu,
 4. Razmatranje Izveštaja Komisije za emergentnu pripravnost, nakon završetka Projekta treniranja za preuzimanje kompetencija parlamentarne kontrole u oblasti bezbednosti,
 5. Razmatranaje Preporuke posebnog Panela u vezi sa mocijom na Zakon o upotrebi jezika,
 6. Razmatranje Preporuke Zakonodavne Komisije za usvajanje liste kandidata za sudije i tužioce.
-

Seancën e kryesoi kryetari i Kuvendit Kolë Berisha

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Kolegë, ju lutem t’i zini vendet.

Të nderuar kolegë deputetë, të nderuar ministra, mirë se keni ardhur në seancën e sotme plenare të Kuvendit të Kosovës.

Ju njoftoj se në sallë janë 74 deputetë, që do të thotë janë plotësuar kushte për punë, prandaj kalojmë në pikën e rendit të ditës.

Jakup Krasniqi e kërkon fjalën.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Z. kryetar, të nderuar deputetë. Grupi Parlamentar i PDK-së kërkon që nga rendi i ditës i seancës së sotme të hiqet pika e 6 e rendit të ditës, që është në shqyrtim për gjyqtarët për faktin se materialin për këtë seancë e kemi marrë sot dhe konsiderojmë se jemi të papërgatitur për të votuar për listën e kandidatëve gjyqtarë që na është ofruar.

Kërkesa e dytë ,gjithashtu ,që vjen nga Grupi Parlamentar i PDK-së ka të bëjë: Sot në një gazetë shkruan se një polic ka dhënë dorëheqje për shkak se në Shërbimin Policor ka njerëz që nuk do të duhej të ishin në atë shërbim, është një nga arsyet e kërkesës sonë që do të vazhdojë. Arsyeya e dytë është që kohë më parë në protestën nga Vetëvendosja një aktivist i saj në zyrat e Shërbimit Policor të Kosovës është rrahur dhe maltretuar fizikisht e është lëshuar dhunshëm muzika e huaj në gjuhën serbe dhe i është sharë nëna, gjithashtu në gjuhën serbokroate në zyrat e Shërbimit Policor të Kosovës. Arsye tjetër për kërkesën tonë është se kohë më parë në një komunë të Kosovës Shërbimi Policor ka kryer një kontroll dhe është gjetur armatim në disa vende që kanë qenë të lidhura.....Në kohën kur në Kosovë kërkohet një shërbim i përgjegjshëm i aftë për të siguruar sigurinë e qytetarëve të Kosovës dhe ndodhin këto deformime, mendoj se është në nderin dhe obligimin e Parlamentit dhe propozoj në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së që të formohet një komision hetimor për t’i vërtetuar këto që i thashë a ekzistojnë dhe a qëndrojnë. Pra,kërkoj që edhe shefat e grupeve parlamentare të deklarohen për këtë çështje- fjala është për formimin e një komisioni hetimor. Ju faleminderit!

KRYETARI - Ju faleminderit z. Krasniqi, fjalën e ka dr. Alush Gashi.

ALUSH GASHI – I nderuari z. kryetar i Kuvendit. Ne kemi marrë propozimin e rendit të ditës dhe si grup parlamentar i kemi shqyrtuar të gjitha propozimet për rendin e ditës dhe kemi nxjerrë këtë përfundim: Ne kërkojmë z. kryetar që do ta merrni në konsiderim vendimin e Grupit Parlamentar të LDK-së që raporti i ART-së të plotësohet. Materiali i cili na është prezantuar neve për këtë seancë mendojmë se nuk mjafton për një debat, prandaj kërkojmë që raporti në seancë plenare të vijë sa më parë që është e mundshme, duke i përfillur të gjitha procedurat e rregullores në fuqi dhe me lutje të posaçme që në këtë proces të jenë shumë aktivë komisionet parlamentare, siç është Komisioni FunkSIONAL, por edhe komisionet e tjera. Ju faleminderit z. kryetar dhe besoj se e merrni në konsideratë që ta hidhni në votë këtë propozim tonin!

KRYETARI – Ju faleminderit. Përfaqësuesi i Grupit Parlamentar të PDK-së e pati një propozim dhe unë mendoj se duhet ta hedhim në votim.